

## **Defter-i sancak-i arvanid si burim për informacione demografike mbi Epirin në kapërcyell nga sundimi bizantin në atë osman**

Para rreth tridhjetë vitesh, me ftesë miqësore nga Evangelos Chrysos, atëkohë profesor në Universitetin e Janinës, pata nderin të mbaja në këtë universitet një kumtesë mbi çështje të ngulimit sllav dhe të toponimisë mesjetare në Epir, e cila u botua pak kohë më vonë<sup>1</sup>. Burimi shkrimor kryesor i përsiatjeve të mia të atëhershme ishte *Defter-i Sancak-i Arvanid*<sup>2</sup> i vitit 1431/32, i hartuar menjëherë pas dorëzimit të Janinës në duart e rrethuesve turq dhe që, në pjesën dërrmuese të tij, duket se bazohet tek një regjistër tatimor i arkivit administrativ vendor i periudhës së vonë bizantine, dhe që u shërbeu pushtetarëve të rinj si bazë fillestare për ndarjen e tokave dhe përcaktimin e taksave. Referati im i atëhershëm trajtonte në radhë të parë rëndësinë e toponimeve për historinë e vendngulimit dhe atë të popullsisë për periudhën e mesjetës së hershme, në atë pjesë të *Sancak*-ut, e cila përputhet plotësisht me krahinën *Παλαιά Ήπειρος (Epirus vetus)*<sup>3</sup> në antikitetin e vonë dhe në fillim të epokës bizantine.

Duke marrë shkas nga kumtesa e atëhershme dhe nga hulumtimet e mëtejshme mbi demografinë e hapësirës bizantine<sup>4</sup>, këtu do të përpiqemi të vlerësojmë informacionet mbi numrin, përhapjen dhe dendësinë e

- 1 J. KODER, Προβλήματα της σλαβικής εποίκησης και τοπωνυμίας στη μεσαιωνική Ήπειρο, *Ηπειρωτικά Χρονικά* 24 (1982) 9–35. Kumtesa u mbajt më 30 mars 1981.
- 2 H. İNALÇIK (Hg.), *Hicrî 835 Tarihli Sûret-i defter-i Sancak-i Arvanid*, Ankara 1954.
- 3 Literaturë e mëtejshme këtu: P. SOUSTAL, *Tabula Imperii Byzantini 3: Nikopolis und Kephallenia* [Denkschriften der philosophisch-historischen Klasse der Österreichischen Akademie der Wissenschaften, 150], unter Mitwirkung von J. KODER, Wien 1981; zur Verwaltung einzelner Provinzen im 13. Jahrhundert: G. PRINZING, *Studien zur Provinz – und Zentralverwaltung im Machtbereich der epirotischen Herrscher Michael I und Theodoros Dukas*, Teil II, *Ηπειρωτικά Χρονικά* 25 (1983) 37–109.
- 4 Khs. bibliografinë në: J. KODER, *Το Βυζάντιο ως χώρος. Εισαγωγή στην ιστορική γεωγραφία της Ανατολικής Μεσογείου στη Βυζαντινή εποχή*, Thessalonike 2004, 294–312. – Literaturë e zgjedhur: E. CHRYSOS, *Settlements of Slavs and Byzantine Sovereignty in the Balkans*, in: K. BELKE – E. KISLINGER – A. KÜLZER – M. STASSINOPOULOU (Hgg.), *Byzantina Mediterranea, Festschrift für Johannes Koder zum 65. Geburtstag*, Wien – Köln – Weimar 2007, 123–135; Z. DJOKOVIĆ, *Stanovništvo istočne Makedonije u prvoj polovini XIV veka (La population de la Macédoine de l'Est dans la première moitié du XIVe siècle)*, *ZRVI* 40 (2003) 97–244; K. MUSTAKAS, *Η δημογραφική κρίση του ύστερου Μεσαίωνα στον ελληνικό χώρο. Η περίπτωση της Νοτιο-Ανατολικής Μακεδονίας (14ος–15ος αι.)*, *Μνήμων* 25 (2003) 9–33; D. ΣΤΑΘΑΚΟΠΟΥΛΟΣ, *Population, demography, and disease*, in: R. CORMACK – J. HALDON – E. JEFFREYS (eds.), *The Oxford Handbook of Byzantine Studies*, Oxford 2008, 309–316, ku secili titull përmban literaturë të mëtejshme.

popullsisë dhe të vendbanimeve në tërë territorin e *Sancak-i Arvanid* osman.

*Sancak-i Arvanid* ose *Arnavud-ili* u krijua prej vitit 1394 në rajonin e dikurshëm bizantin të «Despotatit» të Epirit dhe prej 1415/18 përfshinte Shqipërinë e mesme dhe atë jugore; kryeqendra rajonale ishte Aryurikasrı (Gjirokastër/ Argyrokastron). Ndërmjet viteve 1443 dhe 1459 ushtrimi i pushtetit të Perandorisë Osmane mbi *Sancak*-un ishte cënuar prej disa zhvillimesh ushtarake, kryesisht prej kryengritjes së Skënderbeut, dhe në disa zona të caktuara ishte bërë përkohësisht i pamundur<sup>5</sup>. Pra, në rrjedhën e shek. të 15<sup>-të</sup> rajoni që kemi në shqyrtim i ishte nënshtruar disa herë ndryshimeve të dhunshme të strukturës sunduese, të cilat patën pastaj ndikime në gjendjen ekonomike, në numrin dhe në strukturën e popullsisë.

*Defter-i Sancak-i Arvanid* na paraqet në njëfarë mënyre një fotografim të çastit sepse ai u përpilua më 1431/32, d.m.th. shumë kohë përpara vdekjes së Skënderbeut (1468) dhe përpara stabilizimit të sundimit turk. Defteri na shërben si bazë e orvatjes për rikonstruksionin e një vendngulimi historik, si rrjedhojë e numrit të madh të toponimeve që përmenden aty dhe që, në një pjesë të konsiderueshme, janë edhe të identifikueshme ose të lokalizuara si vende të braktisura, së paku deri në gjysmën e dytë të shek. të 20<sup>-të</sup>; këtë e tregon një krahasim i bërë me hartat moderne dhe sidomos me fletët përkatëse të Hartës së Përgjithshme të Europës Qendrore<sup>6</sup>, e konceptuar rreth fundit të shek. të 19<sup>-të</sup>. Fakti që shumë toponime i referohen zaptimit sllav të tokave në fund të shek. të 6<sup>-të</sup> dhe në fillim të shek. të 7<sup>-të</sup> është sqaruar tashmë më herët<sup>7</sup> dhe përmendet në kontekstin e shtruar për diskutim këtu për arsyen e vetme sepse ky fakt ka rëndësi sa i përket stabilitetit të strukturës së ngulimit.

Defteri trajton një zonë<sup>8</sup> me një sipërfaqe prej rreth 10.700 km<sup>2</sup> midis lumit Ishëm në veri dhe rrjedhës së poshtme të Kalamas, afër Igumenicës në jug; kufiri lindor i rajonit në fjalë kalonte përgjatë vijave ujëndarëse

5 Khs. në përgjithësi K.-P. MATSCHKE, Der Übergang vom byzantinischen Jahrtausend zur Turkokratie und die Entwicklung der südosteuropäischen Region, *Jahrbücher für Geschichte und Kultur Südosteuropas* 1 (1999) 11–38; A. BIRKEN, *Die Provinzen des Osmanischen Reiches*, Wiesbaden 1976, 52; *EP*, v. 9, s.v. Sandjak (J. DENY – M. KUNT), 12–14; mbi Shqipërinë: O. J. SCHMITT, *Das venezianische Albanien (1392–1479)* [Südosteuropäische Arbeiten 110], München 2001.

6 *Karte von Albanien 1:200.000*, nördl. und südl. Blatt, hg. v. Hauptvermessungsabteilung XIV, Wien 1939; shih edhe *Generalkarte Mitteleuropa 1:200.000*, Bl. 38° 40° Korfu, behelfsmäßige Ausgabe, po aty, 1940.

7 KODER, Προβλήματα.

8 Mbi strukturën geografike të rajonit shih P. JORDAN (Hg.), *Albanien: Geographie / historische Anthropologie / Geschichte / Kultur / postkommunistische Transformation*, Wien u.a. 2003; C. LIENAU – G. PRINZING (Hgg.), *Beiträge zur Geographie und Geschichte Albaniens* [Berichte aus dem Arbeitsgebiet Entwicklungsforschung 12], Münster 1986.

malore të lumenjve që derdhen në Adriatik (harta 1<sup>9</sup>). Ky rajon përkon me pjesët perëndimore dhe qendrore të Shqipërisë së mesme dhe jugore, si dhe me pjesë të vogla të Epirit në Greqinë veriperëndimore. Përveç fushave kënetore që shtrihen përgjatë bregdetit, nga veriu deri në Vlorë, me një gjerësi perëndim-lindje që luhartet deri në mbi 50 km, *Sancak-i Arvanid* përbëhet pjesërisht nga një malësi e pakalueshme dhe pak e begatë në pikëpamje bujqësore (orientimi kryesor i vargmaleve është nga V-VP drejt J-JG), ku masivet malore ngrihen deri në mbi 2500 m. Në jug të Vlorës fillon malësia bregdetare e Keraunëve (me lartësi deri pak mbi 2000 m); ajo bie thikë drejt detit Jon dhe për këtë arsye, bregu me gjatësi rreth 100 km midis Orikumit dhe Sarandës është tejet i papërshtatshëm për t'u populluar.

Lumenjtë më të rëndësishëm (prej jugut në veri) janë Pavlla, lumenjtë furnizues të lagunës së Butrintit, Vjosa me lumenjtë dytësorë Shushica dhe Drino, Semani me lumenjtë dytësorë Osumin dhe Devollin, Shkumbini, Erzeni dhe Ishmi (lumi Mat gjendet jashtë zonës së *Sancak Arvanid*). Luginat lumore në fjalë i kanë pikënisjet e tyre, sipas orientimit të malësive, kryesisht në juglindje dhe vijën e hapen për nga veriperëndimi ose perëndimi drejt ultësirës bregdetare. Në këtë mënyrë, janë ato që përcaktojnë drejtimin e rrjetit rrugor mbirajonal.

Në renditjen e tyre, të dhënat e Defterit ndjekin përafërsisht një radhitje nga jugu në veri. Në botimin e Halil İnalçık gjejmë një nënndarje në dhjetë *Vilâyets* ose *Nâhiyets*, me shtrirje sipërfaqësore shumë të ndryshme. Në vështrim të përgjithshëm ndarja e zonave veç e veç paraqitet si më poshtë (harta 2<sup>10</sup>):

[I.] Zona e kryeqytetit të *Sancak*-ut, pra *vilâyet*-i Aryurikasrı (Argyrokastron); kjo përfshinte *nâhiyet*-in Lahtakasru (Lachanokastro), *vilâyet*-in Vayonetya (Bagenetia), *nâhiyet*-in Himara (Cheimara), një pjesë të vogël të *nâhiyet*-it Belgrad (Belgradi, Berat) dhe *nâhiyet*-in Muzakiye<sup>11</sup>; me rreth 3285 km<sup>2</sup> *vilâyet*-i Aryurikasrı ishte shumë më i madh se gjithë distriktet e tjera, sipërfaqet e të cilëve arrinin diku aty midis 160 km<sup>2</sup> dhe 1370 km<sup>2</sup>.

[II.] *nâhiyet*-i Sopot (Sopotos) me 8 timare<sup>12</sup>, rreth 160 km<sup>2</sup>;

[III.] *vilâyet*-i Klisura (Kelcyrë) me 8 timare<sup>13</sup>, rreth 270 km<sup>2</sup>;

9 Harta 1: *Albanien 1:1,000.000*, K. u. k. Militärgeographisches Institut, Wien, o. J.

10 Harta 2: *Vilâyet-et e Sancak-i Arvanid*.

11 Rajoni i sundimit të familjes shqiptare Muzaki, khs. İNALÇIK, *Sancak-i Arvanid*, f. 1-27, Timare 1-58.

12 İNALÇIK, *Sancak-i Arvanid*, f. 27-30, Timare 59-66.

13 İNALÇIK, *Sancak-i Arvanid*, f. 30-33, Timare 67-74.

[IV.] *vilâyet*-i Kanina (Kanina në Vlorë) me 70 timare<sup>14</sup>, rreth 1270 km<sup>2</sup>;

[V.] *vilâyet*-i Belgrad (Berat) me 61 timare<sup>15</sup>, rreth 1295 km<sup>2</sup>;

[VI.] *vilâyet*-i Tomorince (Tomorri) me 10 timare<sup>16</sup>, rreth 260 km<sup>2</sup>;

[VII.] *vilâyet*-i Iskarapar me 25 timare<sup>17</sup>, rreth 585 km<sup>2</sup>;

[VIII.] *vilâyet*-i Pavlo Kurtik me 21 timare<sup>18</sup>, rreth 1100 km<sup>2</sup>;

[IX.] *vilâyet*-i Çartalos me 15 timare<sup>19</sup>, rreth 1105 km<sup>2</sup>;

[X.] *vilâyet*-i Akçahisar (Kroia, Krujë) me 60 timare<sup>20</sup>, rreth 1370 km<sup>2</sup>;

Kufijtë e brendshëm të dhjetë rajoneve brenda *Sancak*-ut janë të paracaktuar nga struktura e sipërfaqes; përgjithësisht ata ndjekin kreshtat malore të vështira për t'u kapërcyer. Përjashtim prej këtij rregulli paraqesin fushat bregdetare midis Lezhës dhe Vlorës. Pesë njësitë administrative të ndodhura në jug ose jugperëndim, dhe njësia më veriore (e dhjeta), ishin emërtuar sipas kryeqendrave të tyre, kurse katër njësitë e tjera sipas emrave krahinorë dhe familjarë. Emrat e pesë provincave të para dhe pothuaj të gjithë emrat e nënndarjeve të provincës<sup>21</sup> së parë janë marrë me shumë gjasë prej kadastrës bizantine; dhe këto – si shumë emra provincash bizantine të mesjetës së vonë – kanë për bazë emrat e kryeqendrave<sup>22</sup>.

Më vonë Perandoria Osmane u nda thujse në mënyrë uniforme në njësi administrative të quajtura *sancaks* (provinca), të cilat ishin pjesë e *eyalets* («rajone») dhe që nënndaheshin më tej në *vilâyets* («qark vendor») ose *kazas* dhe në *nâhiyets* («rreth»), dhe në fund njësitë më të vogla *kurâ* (shumësi i *karye*, nga greq. *chorion*, «fshat») e pastaj *mahalle* («lagje»). Megjithatë, kjo ndarje nuk ka qenë gjithnjë në themel të Defterit. Ndërsa fshati (*karye/chorion*) mbeti gjithnjë njësia më e vogël e tij, ende nuk kemi një dallim të qartë midis *vilâyet* dhe *nâhiyet*.

Si njësi ndarëse të reja, pa lidhje me strukturën historike ekzistuese të vendngulimit epirot, në Defter dalin 335 *timare* (qiradhënie), në të cilat

14 İNALÇIK, *Sancak-i Arvanid*, f. 33–55, Timare 75–144.

15 İNALÇIK, *Sancak-i Arvanid*, f. 55–74, Timare 145–205.

16 İNALÇIK, *Sancak-i Arvanid*, f. 75–77, Timare 206–215.

17 İNALÇIK, *Sancak-i Arvanid*, f. 78–85, Timare 216–239.

18 İNALÇIK, *Sancak-i Arvanid*, f. 85–97, Timare 240–260.

19 İNALÇIK, *Sancak-i Arvanid*, f. 97–102, Timare 261–275.

20 İNALÇIK, *Sancak-i Arvanid*, f. 102–120, Timare 276–335.

21 Përjashtuar Nâhiyet-i Muzakiye, shih poshtëshënimin 10.

22 Kruja mban tashmë emrin turk Akçahisar, Tomorince është emërtuar prej malësisë së Tomorrit, emri i krahinës Iskarapar duhet barazuar me emrin e distriktit të sotëm Skrapar në rajonin e Beratit, Pavlo Kurtik është emri i një timarioti shqiptar, Çartalos duhet ta ketë prejardhjen prej emrit të ndonjë familjeje.

shpesh përfshihen shumë fshatra ose pjesë syresh. Më tej përmenden disa *mevkufât* (prona të përshpirtshme sipas të Drejtës islamike), por që për arsye të kuptueshme numri i tyre është ende aq i vogël, sa që rëndësia ekonomike dhe demografike e tyre në kontekstin e fillim shek. të 15<sup>-të</sup> do të ishte e papërfillshme.

Defteri i vitit 1431/32 (tabela 1) shënon emrat e vendeve, të ndara sipas dhjetë rajoneve të përmendura. Brendapërbrenda rajoneve nuk ka një ndarje të njëtrajtshme dhe konsekuente, edhe pse shpesh janë listuar bashkëngjitur vendet fqinje kufitare, ku timariotët figurojnë gjithnjë në fund. Si rregull, Defteri më tej jep numrin e familjeve të tatueshme, ato me ekonomi familjare të plotë (*hane*) dhe jo të plotë, d.m.th. me një bashkëshort/e të ve (*bîve*) ose beqar/e (*mücerred*). Në përmbyllje, Defteri jep taksat vjetore në para (*akçe*<sup>23</sup>) që duhej të paguanin disa vende ose rajone, por kjo shpesh në mënyrë të paplotë ose jo të dallueshme qartë. Mangësitë, së paku një pjesë e tyre, shpjegohen me faktin se prej dorëzimit të Janinës në tetor 1430 e deri në përpilimin e Defterit pati kaluar pak më shumë se një vit, ndaj për shkaqe të ndryshme praktike nëpunësit që ishin ngarkuar me përcaktimin ose verifikimin e numrit të taksapaguesve ishin tejet të stërmunduar. Për këtë arsye nuk u mundësua një listim i plotë i taksapaguesve; në tekst gjenden shpjegime përkatëse lidhur me mungesat ose me karakterin provizor që kanë disa të dhëna shifrore<sup>24</sup>.

Me një sipërfaqe prej rreth 10.700 km<sup>2</sup> Defteri përfshin rreth 1.285 vendbanime, kryesisht fshatra të vegjël. Disa prej këtyre përmenden disa herë, si rregull në rastin kur kishte disa timariotë që zotëronin prona në të njëjtin fshat<sup>25</sup>. Përgjithësisht mund të thuhet se një fshat mbulonte mesatarisht mbi 10 km<sup>2</sup> sipërfaqe tokash të ndryshme për nga cilësia.

Numri i ekonomive shtëpiake të regjistruara (= njësi të tatueshme) është 22.851<sup>26</sup> dhe po të nisemi nga pikësynimet e këtij hulumtimi, atëherë dallimi i bërë më lart mes ekonomive familjare të plota dhe atyre me një bashkëshort/e të ve ose beqar/e mund të anashkalohej sepse shpesh rezultojnë që shifrat e dhëna mbi dy kategoritë e fundit nuk përlllogariteshin dot prej tagrambledhësve dhe prandaj u lanë fare; faktikisht këto zënë

23 *akçe* („monedhë e vogël, e bardhë“), greq. *aspron*, në burime perëndimore *asper*, monedha standarde (d 18 mm), e cila deri më 1444 (Murad II, †1451) peshonte 1,1g dhe ishte 90% argjend, shih *El<sup>2</sup>, Akçe* (H. BOWEN), 327v.

24 P. sh. kur në Defter shënohet se në ditën e caktuar zyrtarisht nuk ishte paraqitur asnjëri prej krerëve lokalë të ftuar; mbi këtë Sp. SHKURTI, *Der Mythos vom Wandervolk der Albaner. Landwirtschaft in den albanischen Gebieten, 13. – 17. Jahrhundert* [Zur Kunde Südosteuropas, Albanologische Studien 1], Wien [u.a.] 1997, 42f.

25 Kështu shpjegohet shifra totale prej 1.048 fshatrash tek: SHKURTI, *Der Mythos*, f. 38 dhe 41.

26 SHKURTI, *Der Mythos*, në faqen 38 na jep një shifër totale prej 21.880 shtëpish, kurse në faqen 41 disa shifra shtëpish nga të cilat rezultojnë një shumë prej 20.599.

vetëm 6,21%<sup>27</sup>. Pra, një vendbanim përmbante mesatarisht 17,8 ekonomi shtëpiake të tatueshme.

Megjithatë duhet theksuar se numri i përgjithshëm i shtëpive në rajonin *Arvanid* duhet të ketë qenë me siguri më i lartë sesa ai i paraqitur në Defter. Kjo nuk shpjegohet vetëm me karakterin provizor të dokumenteve të përpiluara brenda një kohe të shkurtër, siç u përmend më lart, por edhe me faktin se disa pjesë të bregdetit, që e kufizojnë *Sancak-i Arvanid* nga perëndimi, (ende) nuk i përkisnin territorit perandorak osman. Të tilla ishin qytet-portet e populluara dhe me prapatokë pjellore si: Dyrrachion (Durrës, Durazzo), nën zotërim venedikas deri më 1501, H. Saranta (Sarandë, Santi Quaranta) deri më 1492/3, Buthrotos (Butrinti, Butrint) deri më 1800<sup>28</sup>.

Përveç kësaj, ka edhe të tjerë faktorë pasigurie që karakterizojnë shumë Defterë të hershëm, si p. sh. fakti që ushtarët dhe zotëruesit e timareve ose të feudeve, ose nuk u regjistruan fare ose u regjistruan jo plotësisht. Diçka e ngjashme vlen përgjithësisht edhe për faktin nëse myslimanët u regjistruan në Defter po aq plotësisht sikurse të krishterët, si dhe sa ishte numri i familjeve që jetonin në një rajon të caktuar që nuk u regjistruan ose u regjistruan vetëm pjesërisht sepse nuk zotëronin toka, dhe që kryesisht ishin barinj shtegtarë, pra blegtorë gjysmëndacakë, shpesh vllahë, që sipas të drejtës zakonore mund t'i kullotnin kopetë e tyre përkohësisht nëpër territore të caktuara. Mbi këta Defteri Arvanid nuk jep të dhëna.

Në këto rrethana, edhe pranimi i shifrave mbi popullsinë, bazuar tek regjistrimi i shtëpive në Defter, i nënshtrohet po ashtu pasigurive të lartpërmendura. Një tjetër faktor pasigurie vjen nga numri i personave që i përkisnin një shtëpie. Në vlerësimet që kam bërë, në vend të një mesatarje të njëzuar unë kam marrë një kufi minimal prej 3,5 dhe një kufi maksimal prej 6 personash për çdo familje (tabela 2), e ku shpesh më rezulton një vlerë midis 5<sup>-ës</sup> dhe 6<sup>-ës</sup>. Kjo qasje bazohet në botimet më të fundit mbi demografinë e mesjetës së vonë dhe asaj të kohës së re të Gadishullit Ballkanik, argumentimet e të cilave edhe pse jo me të njëjtën forcë bindëse përdorin vlera brenda këtij kuadri<sup>29</sup>. Për krahasim, edhe një burim i

27 Ekonomi familjare të plota 21.433 = 93,8%, ekonomi me një bashkëshort/e të ve 979 = 4,29 %, ekonomi familjare e një beqari 439 = 1,92 %.

28 Shih SCHMITT, *Das venezianische Albanien*, 215–314 dhe 593–628.

29 Khs. A. LAIOU-THOMADAKIS, *Peasant Society in the Late Byzantine Empire, a Social and Demographic Study*, Princeton 1977, 223–266, veçanërisht 224–227 (midis 3,67 dhe 4,7); J. C. RUSSELL, *Medieval Demography*, New York, NY 1987, 131f. (3,5–5 persona/shtëpi) dhe F. ZARINEBAF – J. BENNET – J. L. DAVIS, *A historical and economic geography of Ottoman Greece. The southwestern Morea in the 18th century* [Hesperia, Suppl. 34], Athen 2005, 158f. (4–4,75 persona/shtëpi); më tej KODER, Προβλήματα, 28–30 (3,5–5 persona/shtëpi); po ai, Überlegungen zur Bevölkerungsdichte des byzantinischen Raumes in Spätmittelalter und Frühneuzeit, *Byz. Forschungen* 12 (1987) 289–305

kohës së re që na informon mbi katër ngulime të një krahine të vogël të Maqedonisë, por e krahasueshme në pikëpamje të gjeografisë fizike, na jep me 5,3–6,5 persona për çdo shtëpi një diapazon vlerash papërfillshmërisht më të larta<sup>30</sup>.

Nisur nga këto premisa, për *Sancak-i Arvanid* na rezultojnë një kuadër midis 79.978 dhe 137.106 banorësh të regjistruar si të tatueshëm, dhe ku shtrirja sipërfaqësore prej rreth 10.700 km<sup>2</sup> e *Sancak*-ut përkon me një dendësi popullore midis 7,4–12,8 banorë/km<sup>2</sup>. Për arsye që u përmendën tashmë më lart (f. 5-6), por edhe për arsyen se u regjistruan vetëm ato shtëpi që ishin të tatueshme, duhet pranuar se vlera më e lartë është ajo më afër realitetit.

Duke konsideruar një rrjedhë të dendur ngjarjesh luftarake nisur nga fundi i shekullit të 14<sup>-të</sup>, përligjet supozimi se numri i popullsisë në shek. e 15<sup>-të</sup> ishte ulur ndjeshëm (pika më e ulët nuk ishte arritur ende, as më 1430). Këtu duhet nënvizuar fakti se burimet shkrimore bizantine të vona përmendin trembëdhjetë emra ngulimesh ose krahinash brenda një konteksti ngjarjesh historiko-politike, që lënë të kuptohet se këto ngulime kishin karakter të ngjashëm me qytetet ose me qendrat tregtare<sup>31</sup>. Ngaqë

---

(3,5–5); D. GEORGIEV, Siedlungsverhältnisse im makedonisch-albanischen Grenzgebiet im 15. und 16. Jahrhundert (nach osmanischen Quellen), *Südostforschungen* 65/66 (2006/2007) 117–136, bazohet tek një faktor 5 pa ndonjë argumentim specifik, N. TODOROV, Quelques aspects de la ville balkanique aux X<sup>e</sup> et XV<sup>e</sup> siècles. Nombre et population, in: *Actes du I<sup>er</sup> congrès international des études du sud-est européen*, II, Athen 1972, 209–219, këtu 211f., nga 5 deri 6,25 persona/shtëpi; SHKURTI, *Der Mythos*, 51f. bën dallimin për shek. 15. / 16. midis njërive të tatueshme (familje) nga 3–5 persona dhe nga 8–10 shtëpi.

30 Prej komenteve shoqëruese të katër plan-skicave të qyteteve maqedonase, të përpiluara nga Wilhelm von Chabert më 1832, dalin relacionet në vijim – *Demirhisar* (Siderokastron): 1:5,3 (850 shtëpi me 4.500 ban., prej nga 3.500 turq dhe 1.200 grekë ose ciganë). – *Seres*: 1:5,5 (4.000 shtëpi me 22.000 ban., prej nga 11.000 turq, 9.000 grekë ose bullgarë, 1.500 hebrej, 500 ciganë). – *Kavala*: 1:5,7 (1.400 shtëpi me 8.000 ban., prej nga 6.000 turq dhe 2.000 grekë ose bullgarë). – *Melenik*: 1:6,5 (1.000 shtëpi me 6.500 ban., prej nga 1.000 turq, të tjerët grekë). Shih mbi këtë M. POPOVIĆ, *Von den Quellen zum Visuellen in der historischen Geographie. Zentrale Orte, Siedlungstheorien und Geoinformatik, angewendet auf die historische Landschaft Makedonien (13. bis 16. Jahrhundert)*, Wien 2011.

31 Mbi këtë japin të dhëna burimet e mëposhtme (nga veriu në drejtim të jugut): *Kroa(i)*: Manuel Philes 3.237.289, Ephraim, Hist. 8734, *Kruai*: Georg. Sphr. 43.3.5. *Dyrrachion*: Georg. Pach., Syngr. Hist. 151, 641–3, Manuel Philes 3.237.289. *Bellegrada*: Manuel Philes 3.237.205 et 218, Georg. Pach., Syngr. Hist. 151, 641–3, Georg. Pach., Hist. brevis 6.32, *Balagrita*: Joh. Kant., Hist. 1.495. *Aulona*: Chron. byz. brev. 60.20.1. *Kan(n)ina*: Laon. Chalk. 2.29, Chron. byz. brev. 60.20.1, Georg. Pach., Syngr. Hist. 151, 641–3, Joh. Kant., Hist. 1.495, Manuel Philes 3.237.289. *Kleisura*: Joh. Kant., Hist. 1.495, Chron. byz. brev. 53.16.2, 54.12.1. *Cheimarra*: Joh. Kant., Hist. 509, *Chimara*: Joh. Apokaukos, Not. Epist. 57.54ff., 74.1,

këto toponime gjejnë përputhje veçse të pjesshme me të dhënat e Defterit, mund të dalim po ashtu në përfundimin se në shek. e 15<sup>-të</sup> densiteti i vendbanimeve kryesore (dhe atyre në përgjithësi) ishte më i ulët se më parë, d.m.th. krahasuar me periudhën bizantine të vonë dhe më pas me periudhën osmane, sepse duke nisur prej shek. të 16<sup>-të</sup> disa prej këtyre qendrave u njihet shprehimisht (sërish) karakteri qytetar<sup>32</sup>. Pavarësisht kësaj, numri total i popullsisë (dhe dendësia e saj) në rajonin e Shqipërisë së mesme dhe jugore ishte edhe më i lartë, sepse qytet-portet dhe zonat bregdetare të populluara dendur i përkisnin atëkohë në shumicë, siç u përmend, Venedikut.

I vetmi port i madh që kontrollohej nga pala osmane dhe që mundësonte një lidhje me rrugët detare të Adriatikut dhe të Detit Jon, ishte ai i Vlorës (Aulon, Avlona, Valona); prej vitit 1417 turqit ishin në zotërim të kështjellës dhe të qytezës së Kaninës, e ndodhur rreth 4 km larg mbi Vlorë, arsye për të cilën Kanina edhe në Defter emërtohet si kryeqendër e Vilâyet-it me të njëjtin emër.

Nuk dihet nëse Gjiri i Borshit në juglindje të Himarës, më pak i përshtatshëm si liman, kontrollohej gjithashtu nga turqit; kryeqendra osmane Sopot (kryeqendër e Nâhiyet-it me të njëjtin emër në Defter) nuk shtrihej direkt në bregdet, përgjatë të cilit nga Vlora në Sarandë ka vetëm pak gjire e skela të përshtatshme për lundrim.

Në përgjithësi, dendësia e popullsisë përfshirë edhe territoret venedikase mbeti me shumë gjasa nën 20 banorë/km<sup>2</sup>; pra ajo ishte e ulët, çfarë konfirmohet indirekt edhe përmes vlerave krahasuese të shekullit të 20<sup>-të</sup><sup>33</sup>. Përpjekja për të diferencuar më tej rajonet brenda Sankcak-ut nuk është shumë e suksesshme. Renditja e bërë sipas ndarjes zonale *Veri / Qendër / Jug* (tabela 3) na jep tre rajone të krahasueshme për nga shtrirja sipërfaqësore, por nuk mundëson bërjen e dallimeve thelbësore: Veriu

---

PRK I 2.43,49, PRK III 252.4,6.

*Sopotos*: Joh. Kant., Hist. 509.

*Argyrokastron*: Chron. byz. brev. 60.2.12 u.ö., Joh. Kant., Hist. 509, *Argyropolichne*: Laon. Chalk. 1.196, 2.27–29, Chron. Tocc. 3220.

*Mesopotamon*: Joh. Kant., Hist. 509, PRK I 2.35.

Rajoni *Muzakea*: Chron. Tocc. 1682.

Rajoni (dhe *phurion* / kështjellë) *Skreparion*: Joh. Kant., Hist. 1.495.

Rajoni *Bagenetia*: Chron. Mor. 9162, Dem. Chomat., Ponemata 44.2, *Bagenitia*: Joh. Apokaukos, Not. Epist. 57.71, PRK I 2.33.

32 Sipas SHKURTI, *Der Mythos*, f. 130, në fillim të sundimit osman Shkodra, Kruja, Lezha, Durrësi, Vlora dhe Gjirokastra duhen shënuar tashmë si qytete, ndërsa ngulimet në vijim filluan të zhvillohen si qytete vetëm nisur prej kësaj kohe (deri më 1600), ndërsa më parë ishin ose fshatra ose nuk ekzistonin ende: Delvina, Kavaja, Elbasani, Gjakova, Peqini, Korça dhe Prishtina.

33 Në vitin 1923 Shqipëria kishte 803.948 banorë, pra një dendësi popullesie prej 28 ban./km<sup>2</sup>, khs. LIENAU - PRINZING, *Beiträge zur Geographie*, 128, Tabela 2.



7.5–12.8 / Qendra 7.3–12.8 / Jugu 7.6–13.0 banorë/km<sup>2</sup>.

Nëndarja e logjikshme në rajone të prapatokës dhe në rajone bregdetare (tabela 4), që përkon gjerësisht me një nëndarje Lindje dhe Perëndim, gjithashtu nuk sjell dallime të qenësishme sepse ultësira bregdetare ishte pjesërisht moçalore dhe sepse Defteri (ende) nuk kishte mundur të regjistronte vendbanime të rëndësishme në bregdet, për shkaqe politike të përmendura tashmë. Bie në sy fakti se qarku administrativ Kleisura, megjithë strukturën malore të sipërfaqes dhe distancën e madhe të tij nga bregdeti, ishte i populluar relativisht dendur; kjo duhet shpjeguar në radhë të parë me rëndësinë e tij – pavarësisht rrethanave natyrore që vështirësonin transportin – si pikëprerje e rrugëve të rëndësishme për tregtinë e brendshme.

«Kundërprova» të bëra në formën e një renditjeje sipas *dendësisë së popullsisë* (tabela 5) ose sipas *shtrirjes sipërfaqësore* (tabela 6) të qarqeve administrative, na japin disi më shumë të dhëna, aq sa del e qartë që tre rajonet më të vegjël për nga sipërfaqja – Sopot, Tomorince dhe Klisura – duket se kanë njëkohësisht edhe dendësitë më të mëdha të popullsisë. Megjithatë, kjo nuk vlen për qarkun tjetër të vogël të Muzakiye. Një shpjegim i mundshëm për këtë mund të jetë si vijon: tre qarqet e përmendura fillimisht kanë të përbashkët faktin se ishin të vegjël dhe, për rrjedhojë, regjistrimi i tyre nga pushtetarët lokalë dhe nëpunësit përkatës ishte administrativisht më i lehtë dhe më i shpejtë sesa në rajonet me sipërfaqe më të madhe; përveç kësaj, në pikëpamje të rrjetit komunikativ Sopot dhe Klisura kishin një vendodhje relativisht më të favorshme sesa kryeqyteti i *Sancak*-ut Aryurikasrı, si dhe kishin përkatësisht qyteza të fortifikuara me garnizon në qendër; së fundi, Sopot shtrihej në bregdet dhe kishte një port, kurse Klisura, siç u përmend, ishte e rëndësishme për tregtinë e brendshme. Muzakiye nga ana tjetër ndodhej larg prej qendrës dhe nuk nxirrte asnjë përfitim prej bregdetit të afërm, ngaqë ky ende ishte nën kontrollin venedikas dhe, veç kësaj, përbëhej më së shumti prej fushash moçalore.

Përmbledhtazi na rezulton se, *Defter-i Sancak-i Arvanid* paraqet një burim të pasur për historinë e ngulimit dhe demografinë historike të krahinës së Epirit në mesjetën e vonë dhe në kohën e re, po të kihen parasysh situata fiziko-gjeografike specifike e rajonit dhe rrethanat në të cilat u përftua ky Defter dhe, më tej akoma, nëse mbajmë parasysh veçoritë e përgjithshme të Defterëve të hershëm osmanë.

Në këto kushte, Defteri nuk ofron vetëm një kornizë themeltare për një paraqitje strukturore të zhvillimit të ngulimit dhe shifrave të popullsisë, por përtej kësaj – siç do të tregohet në vazhdimësi – edhe një platformë të përdorshme për hulumtime mbi rrjetin komunikativ, mbi hierarkinë e ngulimit dhe përgjithësisht mbi historinë ekonomike të rajonit, në kapërcyell nga epoka e mesjetës në kohën e re.

## Vërejtje korrektuese

Botime më të reja si në vijim nuk mundën të pasqyrohen:

M. DELËLBAŞI, A CONTRIBUTION TO THE History of Epirus (XVth-XVIth Centuries) – Special Reference to the Privileges Granted to the People of Epirus by Sultan Murad II, *GAMER* 1.1 (Ankara 2012) 37-60.

The Cambridge history of Turkey, II. The Ottoman empire as a world power, 1453 – 1603, hg. v. S. N. FAROQHI, Cambridge 2013.

(Tabela 1) *Sancak-i Arvanid*: sipërfaqe, fshatra, shtëpi, të ardhura<sup>34</sup>

<i>Provincë</i>	$\approx$ km <sup>2</sup>	<i>fshatra</i>	<i>Vh / Wi / Le</i>	$\Sigma$ Hh	<i>të ardhura</i>
<b>[I] Aryurikasrı</b>	<b>3285</b>	<b>243</b>	<b>5092 / 317 / 373</b>	<b>5782</b>	
Timar 1 Beği	---	36	951 / 59 / 103	1113	91333
Timare 2-58	---	132	2453 / 143/146	2742	189252 +
Lahtakasru	190	9	175 / 4 / 2	181	10588
Vayonetya	515	29	837 / 75 / 95	1007	84616
Himara	90	10	229 / 23 / 22	274	19192
Belgrad	50 <sup>35</sup>	5	111 / 3 / 4	118	13946
Muzakiye	400	22	336 / 10 / 1	347	52301
<b>[II] Sopot</b>	<b>160</b>	<b>27</b>	<b>541 / 10 / 12</b>	<b>563</b>	
Timar 59 Subaşı	---	13	280 / 2 / 2	284	20013
Timare 60-66	---	14	261 / 8 / 10	279	15939 +
<b>[III] Klisura</b>	<b>270</b>	<b>55</b>	<b>1199 / 33 / 2</b>	<b>1233</b>	
Timar 67 Subaşı	---	21	541 / 15 / --	556	33257
Timare 68-74	---	34	658 / 18 / 2	678	2430 ++
<b>[IV] Kanina</b>	<b>1270</b>	<b>208</b>	<b>2328 / 183 / 2</b>	<b>2513</b>	
Timar 75 Subaşı	---	10	397 / 43 / --	440	46208
Timare 76-144	---	198	1931 / 140 / 2	2073	194506 ++
<b>[V] Belgrad</b>	<b>1295</b>	<b>155</b>	<b>2623 / 110 / 49</b>	<b>2782</b>	
Timar 145 Subaşı	---	11	617 / 44 / 32	693	50762
Timare 146-205	---	144	2006 / 66 / 17	2089	154374
<b>[VI] Tomorince</b>	<b>260</b>	<b>33</b>	<b>749 / 25 / --</b>	<b>774</b>	
Timare 206-215	---	33	749 / 25 / --	774	37985

34  $\approx$  afërsisht, (e tatueshme) Hh = ekonomi shtëpiake, Vh = ekonomi familjare e plotë, Wi = ekonomi familjare me bashkëshort/e të ve, Le = ekonomi familjare e një beqari,  $\Sigma$  = shuma, të ardhura (*hâsıl*) në *akçe* (shih poshtëshënimin 22), + = mungojnë pak të dhëna, ++ = mungojnë shumë të dhëna, +++ = pa të dhëna.

35 Këto 50 km<sup>2</sup> iu zbritën sipërfaqes totale të Vilâyet Belgrad dhe iu shtuan atij të Aryurikasrı.

<b>[VII] Iskarapar</b>	<b>585</b>	<b>68</b>	<b>1160 / 51 / 1</b>	<b>1212</b>	
Timar 216 Subaşi	---	23	404 / 22 / --	426	33644
Timare 217-239	---	45	756 / 29 / 1	786	48667 +
<b>[VIII] Pavlo Kurtik</b>	<b>1100</b>	<b>175</b>	<b>2878 / 39 / --</b>	<b>2917</b>	
Timar 240 Beğ	---	77	1082 / 18 / --	1100	86747 ++
Timare 241-260	---	98	1796 / 21 / --	1817	126544 ++
<b>[IX] Çartalos</b>	<b>1105</b>	<b>105</b>	<b>2644 / 41 / --</b>	<b>2685</b>	
Timar 261 Subaşi	---	11	694 / 10 / --	704	41978
Timare 262-275	---	40	808 / 10 / --	818	101092
Mevkufât	---	54	1142 / 21 / --	1163	47848
<b>[X] Akçahisar</b>	<b>1370</b>	<b>216</b>	<b>2219 / 170 / --</b>	<b>2389</b>	
Timar 276 Subaşi	---	27	369 / 21 / --	390	32668
Akçahisar nefis	---	--	125 / 19 / --	144	+++
Timare 277-335	---	189	1725 / 130 / --	1855	164086
<b>Σ Sancak Arvanid</b>	<b>10700</b>	<b>1285</b>	<b>21433 / 979 / 439</b>	<b>22851</b>	<b>1699976++</b>

(Tabela 2) *Sancak-i Arvanid*: sipërfaqe, fshatra, ekonomi shtëpiake, banorë, dendësi e popullsisë (3.5-6 banorë/shtëpi)<sup>36</sup>

<i>Provincë</i>	<i>≈ km<sup>2</sup></i>	<i>fshatra</i>	<i>ΣHh</i>	<i>≈ banorë</i>	<i>≈ banorë / km<sup>2</sup></i>
Aryurikasrı	3285	243	5782	20237–34692	6.1–10.6
Lahtakasru	190	9	181	633–1086	3.3–5.7
Vayonetya	515	29	1007	3524–6042	6.8–11.7
Himara	90	10	274	959–1644	10.6–18.3
Belgrad	50	5	118	413–708	8.2–14.2
Muzakiye	400	22	347	1214–2082	3.0–5.2
Sopot	160	27	563	1970–3378	12.3–21.1
Klisura	270	55	1233	4315–7398	15.9–27.4
Kanina	1270	208	2513	8795–15078	6.9–11.9
Belgrad	1295	155	2782	9739–16692	7.5–12.9
Tomorince	260	33	774	2709–4644	10.4–17.9
Iskarapar	585	68	1212	4242–7272	7.2–12.4
Pavlo Kurtik	1100	175	2917	10209–17502	9.2–15.9
Çartalos	1105	105	2685	9397–16110	8.5–14.6
Akçahisar	1370	216	2389	8361–14334	6.1–10.5
<b>Σ Sancak Arvanid</b>	<b>10700</b>	<b>1285</b>	<b>22851</b>	<b>79978–137106</b>	<b>7.4–12.8</b>

36 ≈ afërsisht, (e tatueshme) Hh = ekonomi shtëpiake, Σ = shuma, (të tatueshëm) banorë (3,5–6 /shtëpi). – Për banorët merret një vlerë minimale prej 3,5 dhe një maksimale prej 6 personash për shtëpi, krahaso këtu me bibliografinë e përmendur në poshtëshënimin 28.

(Tabela 3) *Sancak-i Arvanid*, veri/qendër/jug  
Sipërfaqe, fshatra, shtëpi, numër banorësh, dendësi popullsie (3.5–6 ban./  
shtëpi)<sup>37</sup>

<i>Provincë</i>	$\approx km^2$	<i>fshatra</i>	$\Sigma Hh$	$\approx banorë$	$\approx banorë / km^2$
<b><math>\Sigma</math> Sancak Arvanid</b>	<b>10700</b>	<b>1285</b>	<b>22851</b>	<b>79978–137106</b>	<b>7.4–12.8</b>
[X] Akçahisar	1370	216	2389	8361–14334	6.1–10.4
[VIII] Pavlo Kurtik	1100	175	2917	10209–17502	9.2–15.9
<b><math>\Sigma</math> Veriu</b>	<b>2470</b>	<b>391</b>	<b>5306</b>	<b>18571–31836</b>	<b>7.5–12.8</b>
[IX] Çartalos	1105	105	2685	9397–16110	8.5–14.5
[I] Muzakiye	400	22	347	1214–2082	3.0–5.2
[V] Belgrad <sup>38</sup>	1345	160	2900	10150–17400	7.5–12.9
[VI] Tomorince	260	33	774	2709–4644	10.4–17.8
[VII] Iskarapar	585	68	1212	4242–7272	7.2–12.4
[IV] Kanina	1270	208	2513	8795–15078	6.9–11.8
<b><math>\Sigma</math> Qendra</b>	<b>4965</b>	<b>596</b>	<b>10431</b>	<b>36508–63586</b>	<b>7.3–12.8</b>
[III] Klisura	270	55	1233	4315–7398	15.9–27.4
[II] Sopot	160	27	563	1970–3378	12.3–21.1
[I] Aryurikasri <sup>39</sup>	2835	216	5317	18609–31902	6.5–11.2
<b><math>\Sigma</math> Jugu</b>	<b>3265</b>	<b>298</b>	<b>7113</b>	<b>24895–42678</b>	<b>7.6–13.0</b>

37  $\approx$  afërsisht, (e tatueshme) Hh = ekonomi shtëpiake,  $\Sigma$  = shuma, (të tatueshëm) banorë (3,5–6 /shtëpi). – Për banorët merret një vlerë minimale prej 3,5 dhe një maksimale prej 6 personash për shtëpi, krahaso këtu me bibliografinë e përmendur në poshtëshënimin 28.

38 Me Belgrad, Muzakiye.

39 Me Lahtakasru, Vayonetya, Himara, pa Belgrad, Muzakiye.

(Tabela 4) *Sancak-i Arvanid*, prapatoka/vise bregdetare  
Sipërfaqe, fshatra, shtëpi, numër banorësh, dendësi popullesie (3.5–6 ban./  
shtëpi)<sup>40</sup>

<i>Provincë</i>	$\approx km^2$	<i>fshatra</i>	$\Sigma Hh$	$\approx banorë$	$\approx banorë / km^2$
<b><math>\Sigma</math> Sancak Arvanid</b>	<b>10700</b>	<b>1285</b>	<b>22851</b>	<b>79978–137106</b>	<b>7.4–12.8</b>
[IX] Çartalos	1105	105	2685	9397–16110	8.5–14.5
[V] Belgrad <sup>41</sup>	1345	160	2900	10150–17400	7.5–12.9
[VI] Tomorince	260	33	774	2709–4644	10.4–17.8
[VII] Iskarapar	585	68	1212	4242–7272	7.2–12.4
[III] Klisura	270	55	1233	4315–7398	15.9–27.4
<b>Prapatoka</b>	<b>3565</b>	<b>421</b>	<b>8804</b>	<b>30813–52824</b>	<b>8.6–14.8</b>
(idem pa Klisura)	3295	366	7571	26498–45426	8.0–13.8)
[X] Akçahisar	1370	216	2389	8361–14334	6.1–10.4
[VIII] Pavlo Kurtik	1100	175	2917	10209–17502	9.2–15.9
[I] Muzakiye	400	22	347	1214–2082	3.0–5.2
[IV] Kanina	1270	208	2513	8795–15078	6.9–11.8
[II] Sopot	160	27	563	1970–3378	12.3–21.1
[I] Aryurikasri <sup>42</sup>	2835	216	5317	18609–31902	6.5–11.2
<b>Vise bregdetare</b>	<b>7135</b>	<b>864</b>	<b>14046</b>	<b>49158–84276</b>	<b>6.9–11.8</b>

40  $\approx$  afërsisht, (e tatueshme) Hh = ekonomi shtëpiake,  $\Sigma$  = shuma, (të tatueshëm) banorë (3,5–6 /shtëpi). – Për banorët merret një vlerë minimale prej 3,5 dhe një maksimale prej 6 personash për shtëpi, krahaso këtu me bibliografinë e përmendur në poshtëshënimin 28.

41 Me Belgrad, Muzakiye.

42 Me Lahtakasru, Vayonetya, Himara, pa Belgrad, Muzakiye.

(Tabela 5) *Sancak-i Arvanid*, rajonet sipas dendësisë  
Sipërfaqe, fshatra, shtëpi, numër banorësh, dendësi popullsie (3.5–6 ban./  
shtëpi)<sup>43</sup>

<i>Provincë</i>	$\approx km^2$	<i>fshatra</i>	$\Sigma Hh$	$\approx banorë$	$\approx banorë / km^2$
<b><math>\Sigma</math> Sancak Arvanid</b>	<b>10700</b>	<b>1285</b>	<b>22851</b>	<b>79978–137106</b>	<b>7.4–12.8</b>
[I] Muzakiye (M)	400	22	347	1214–2082	3.0–5.2
[X] Akçahisar (N)	1370	216	2389	8361–14334	6.1–10.4
[I] Aryurikasrı <sup>44</sup> (S)	2835	216	5317	18609–31902	6.5–11.2
[IV] Kanina (M)	1270	208	2513	8795–15078	6.9–11.8
[VII] Iskarapar (M)	585	68	1212	4242–7272	7.2–12.4
[V] Belgrad <sup>45</sup> (M)	1345	160	2900	10150–17400	7.5–12.9
[IX] Çartalos (M)	1105	105	2685	9397–16110	8.5–14.5
[VIII] Pavlo Kurtik (N)	1100	175	2917	10209–17502	9.2–15.9
[VI] Tomorince (M)	260	33	774	2709–4644	10.4–17.8
[II] Sopot (S)	160	27	563	1970–3378	12.3–21.1
[III] Klisura (S)	270	55	1233	4315–7398	15.9–27.4

(Tabela 6) *Sancak-i Arvanid*, rajonet sipas madhësisë  
Sipërfaqe, fshatra, shtëpi, numër banorësh, dendësi popullsie (3.5–6 ban./  
shtëpi)<sup>46</sup>

<i>Provincë</i>	$\approx km^2$	<i>fshatra</i>	$\Sigma Hh$	$\approx banorë$	$\approx banorë / km^2$
<b><math>\Sigma</math> Sancak Arvanid</b>	<b>10700</b>	<b>1285</b>	<b>22851</b>	<b>79978–137106</b>	<b>7.4–12.8</b>
[II] Sopot (S)	160	27	563	1970–3378	12.3–21.1
[VI] Tomorince (M)	260	33	774	2709–4644	10.4–17.8
[III] Klisura (S)	270	55	1233	4315–7398	15.9–27.4
[I] Muzakiye (M)	400	22	347	1214–2082	3.0–5.2

43  $\approx$  afërsisht, (e tatueshme) Hh = ekonomi shtëpiake,  $\Sigma$  = shuma, (të tatueshëm) banorë (3,5–6 /shtëpi). – Për banorët merret një vlerë minimale prej 3,5 dhe një maksimale prej 6 personash për shtëpi, krahaso këtu me bibliografinë e përmendur në poshtëshënimin 28.

44 Me Lahtakasru, Vayonetya, Himara, pa Belgrad, Muzakiye.

45 Me Belgrad, Muzakiye.

46  $\approx$  afërsisht, (e tatueshme) Hh = ekonomi shtëpiake,  $\Sigma$  = shuma, (të tatueshëm) banorë (3,5–6 /shtëpi). – Për banorët merret një vlerë minimale prej 3,5 dhe një maksimale prej 6 personash për shtëpi, krahaso këtu me bibliografinë e përmendur në poshtëshënimin 28.

[VII] Iskarapar (M)	585	68	1212	4242–7272	7.2–12.4
[VIII] Pavlo Kurtik (N)	1100	175	2917	10209–17502	9.2–15.9
[IX] Çartalos (M)	1105	105	2685	9397–16110	8.5–14.5
[IV] Kanina (M)	1270	208	2513	8795–15078	6.9–11.8
[V] Belgrad <sup>47</sup> (M)	1345	160	2900	10150–17400	7.5–12.9
[X] Akçahisar (N)	1370	216	2389	8361–14334	6.1–10.4
[I] Aryurikasrı <sup>48</sup> (S)	2835	216	5317	18609–31902	6.5–11.2

Ky kontribut asht botue së pari në: AUREUS, ΤΟΜΟΣ ΑΦΙΕΡΩΜΕΝΟΣ ΣΤΟΝ ΚΑΘΗΓΗΤΗ ΕΥΑΓΓΕΛΟ Κ. ΧΡΥΣΟ, επιστημονικοί επιμελητές Ταξιάρχης Γ. Κόλιας – †Κωνσταντίνος Γ. Πιτσάκης, επιμελεια υλης Κατερίνα Συνέλλη, ΑΘΗΝΑ 2014. Falenderojmë Autorin për lejen e përkthimit dhe botimin në gjuhën shqipe. (*Shêjzat*).

### Përktheu nga gjermanishtja Raim Beluli

#### Abstract

Grounded on the studies on the toponymy and demography in the Byzantine territories in the late Middle ages, Austrian Byzantinist and Medievalist Johannes Koder reports in this paper on figures, the distribution and the density of populace and settlements within the territory of the Ottoman *Sancak-i Arvanid*. Such territory encompassed vast lands, starting from the river Ishëm in the north and Igumenitza in its southernmost extremity. Divided up into ten administrative areas, its capital was Gjirokastra.

The author refers mainly to the *Defter-i Sancak-i Arvanid* – the tax collection book (1431-1432) kept by the new rulers, the Ottomans. Based on these data and thank to in-depth studies, Prof. Koder contributes to the re-definition of a vast historical area with special respect to its demography, geography, administration, economy and even toponymy. As the data on the Albanians from that time are limited, this study is further documentation to the continuity between the Middle age Albanians and the present-day *shqiptarë*.

In addition, Koder emphasises that certain villages can still be spotted. Though some of them lie in decay now, they were inhabited at least until the second half of the 20th century.

47 Me Belgrad, Muzakiye.


48 Me Lahtakarsu, Vayonetya, Himara, pa Belgrad, Muzakiye.



Karte 1



**DIE VILÂYETS DES SANCAK-I ARVANID**



Karte 2